



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1939/4 prot

Datë, 22.10.2021

V E N D I M
K.P.P. 801/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 22.10.2021 shqyrtoi ankesën përkatësisht me:

Objekt: Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Climacasa” SHPK, nga autoriteti kontraktor, në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr.*REF-07524-10-07-2021* me objekt: “*Shërbim mirëmbajtje për impijantet e ngrohjes dhe rrjetet e furnizimit me ujë të pijshëm*”, me fond limit 33.333.300 lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 25.10.2021 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike.

Vazhdimi i procedurës së shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.

Autoriteti Kontraktor: Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve Publike
Rruga “5 Maji”, Godina 17, Tregu i Medresesë, Tiranë

Ankimues: “Climacasa” SHPK
Lagja “Besëlidhja”, Rruga “Shtraus”, Pll. Nr.1, Lezhë

Baza Ligjore: Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, neni 24 e vijues

Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 08.10.2021 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr.REF-07524-10-07-2021 me objekt: “Shërbim mirëmbajtje për impijantet e ngrohjes dhe rrjetet e furnizimit me ujë të pijshëm”, me fond limit 33.333.300 lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 25.10.2021 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike.

II.2. Në datën 13.10.2021 operatori ekonomik “Climacasa” SHPK ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Njëpërmjet shkresës nr.4261/4 prot., datë 18.10.2021, protokolluar me tonën me nr.1939/2 prot., datë 20.10.2021 me objekt “Kthim përgjigje ankesës së operatorit ekonomik ankimues”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik akti i trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II.5. Referuar shkresës së mësipërme të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Climacasa” SHPK dhe e ka njoftuar atë, se ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës.

Konkretisht, në kthim-përgjigjen e autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka pranuar pretendimet si vijon:

“ 1. Përsa i përket pikës 4.1), të ankesës së operatorit ekonomik “Climacasa” shpk, ju bëjmë me dije se ankesa juaj pranohet. Nisur sa më sipër ndryshimi do të pasqyrohet në Shtojcën bashkëlidhur kësaj shkrese:

2.15 Pranohen variantet:

Po	Jo	X
----	----	---

2.15.1 Pranohet nënkontraktimi:

Po	Jo	X
----	----	---

Sa më sipër, ankesa juaj për këtë kriter qëndron.

2. Për sa i përket pikës 4.2) të ankesës së operatorit “Climacasa” shpk, ju bëjmë me dije se në SPE është publikuar njoftimi për modifikimin DST dhe është pasqyruar vlera e sigurimit të ofertës. (referohuni dokumentave të publikuar në SPE).

Së pari në seksionin 3.1., 3.1.2 dhe 3.1.3 të DST saktësojmë se vlera e sigurimit të ofertës në 2% e vlerës së fondit limit, konkretisht vlera e sigurimit të ofertës do të jetë 666 666 lekë.

3.1 Sigurimi i ofertës: (e zbatueshme në rastin e procedurave të prokurimit me një vlerë më të lartë se sa prokurimi me vlerë të vogël).

Në rastin e kontratave sektoriale, enti kontraktor, në bazë të diskrecionit të tij, mund të kërkojë sigurimin e ofertës edhe për procedurat nën kufirin e lartë monetar. Operatori ekonomik paraqet Formularin e Sigurimit të Ofertës, sipas shtojcës 3.

Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës është 2 (dy) % pra në vlerën 666 666 lekë.

3.1.3 Autoriteti/enti kontraktor pranon pagesën e vlerës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi edhe në formën:

i. garancisë bankare x

ose

ii. nga shoqëri sigurimi të licensuara nga autoritetet kompetente x

3.2 Periudha e vlefshmërisë së ofertës: 150 (shprehur në ditë) ditë.

Sa më sipër ankesa juaj për këtë kriter qëndron.

3. Përsa i përket pikës 4.3), të ankesës së operatorit “Climacasa” shpk, ju bëjmë me dije se: kriteri i vendosur për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, jo më pak se 40 % e vlerës së fondit limit të marrëveshjes kuadër. Këto shërbime të ngjashme duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a) kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin lëshuar nga institucioni shtetëror ose faturat tatimore ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e kryera.

b) kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e kryera.

Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 77 të ligjit nr.162 të LPP dhe nenin 41 pika 3, të VKM nr.285 datë 19.05.2021.

Nisur sa më sipër të ankesës së operatorit ekonomik “Climacasa” shpk ju bëjmë me dije se ankesa juaj pranohet. Nisur sa më sipër ndryshimi do të pasqyrohet në shtojcën bashkëlidhur kësaj shkrese. Sa më sipër ankesa juaj për këtë kriter qëndron.

7. Përsa i përket pikës 4.7) të ankesës së autoritetit kontraktor në lidhje me disponueshmërinë e mjeteve të transportit dhe mjeteve të punës, ju bëjmë me dije se ankesa juaj për këtë kriter qëndron. Kriteri për disponimin e tyre do të konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e Formularit të Vetëdeklarimit, dhe si dokumentacion fizik në formatin e kërkuar nga ligji do të dorëzohet pas shpalljes fitues.”

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues për modifikimin e dokumentave të tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Referuar shkresës së mësipërme të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Climacasa” SHPK dhe e ka njoftuar atë, se ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës.

Konkretisht, në kthim-përgjigjen e autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka pranuar pretendimet si vijon:

“ 1. Përsa i përket pikës 4.1), të ankesës së operatorit ekonomik “Climacasa” shpk, ju bëjmë me dije se ankesa juaj pranohet. Nisur sa më sipër ndryshimi do të pasqyrohet në Shtojcën bashkëlidhur kësaj shkrese:

2.15 Pranohen variantet:

Po Jo X

2.15.1 Pranohet nënkontraktimi:

Po Jo X

Sa më sipër, ankesa juaj për këtë kriter qëndron.

2. Për sa i përket pikës 4.2) të ankesës së operatorit “Climacasa” shpk, ju bëjmë me dije se në SPE është publikuar njoftimi për modifikimin e DST dhe është pasqyruar vlera e sigurimit të ofertës. (referohuni dokumentave të publikuar në SPE).

Së pari në seksionin 3.1., 3.1.2 dhe 3.1.3 të DST saktësojmë se vlera e sigurimit të ofertës në 2% e vlerës së fondit limit, konkretisht vlera e sigurimit të ofertës do të jetë 666 666 lekë.

3.1 Sigurimi i ofertës: (e zbatueshme në rastin e procedurave të prokurimit me një vlerë më të lartë se sa prokurimi me vlerë të vogël).

Në rastin e kontratave sektoriale, enti kontraktor, në bazë të diskrecionit të tij, mund të kërkojë sigurimin e ofertës edhe për procedurat nën kufirin e lartë monetar. Operatori ekonomik paraqet Formularin e Sigurimit të Ofertës, sipas shtojcës 3.

Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës është 2 (dy) % pra në vlerën 666 666 lekë.

3.1.3 Autoriteti/enti kontraktor pranon pagesën e vlerës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi edhe në formën:

*i. garancisë bankare x
ose*

ii. nga shoqëri sigurimi të licensuara nga autoritetet kompetente x

3.2 Periudha e vlefshmërisë së ofertës: 150 (shprehur në ditë) ditë.

Sa më sipër ankesa juaj për këtë kriter qëndron.

3. Përsa i përket pikës 4.3), të ankesës së operatorit “Climacasa” shpk, ju bëjmë me dije se: kriteri i vendosur për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, jo më pak se 40 % e vlerës së fondit limit të marrëveshjes kuadër. Këto shërbime të ngjashme duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a) kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin lëshuar nga institucioni shtetëror ose faturat tatimore ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e kryera.

b) kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e kryera.

Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 77 të ligjit nr.162 të LPP dhe nenin 41 pika 3, të VKM nr.285 datë 19.05.2021.

Nisur sa më sipër të ankesës së operatorit ekonomik “Climacasa” shpk ju bëjmë me dije se ankesa juaj pranohet. Nisur sa më sipër ndryshimi do të pasqyrohet në shtojcën bashkëlidhur kësaj shkrese. Sa më sipër ankesa juaj për këtë kriter qëndron.

7. Përsa i përket pikës 4.7) të ankesës së autoritetit kontraktor në lidhje me disponueshmërinë e mjeteve të transportit dhe mjeteve të punës, ju bëjmë me dije se ankesa juaj për këtë kriter qëndron. Kriteri për disponimin e tyre do të konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e Formularit të Vetëdeklarimit, dhe si dokumentacion fizik në formatin e kërkuar nga ligji do të dorëzohet pas shpalljes fitues.”

III.1.2. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera.”

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 115 pika 1 dhe 2 e ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr.REF-07524-10-07-2021 me objekt: “Shërbim mirëmbajtje për impjantet e ngrohjes dhe rrjetet e furnizimit me ujë të pijshëm”, me fond limit 33.333.300 lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 25.10.2021 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike.

2. Të vazhdojë procedurën e shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.
 3. Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri